

PASQYRAT FINANCIARE TË SHOQËRISË

« AUTO EKSPRES »SHPK

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCËS	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5-15

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Mjete monetare	4	149,926	118,243
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	12,001,434	9,766,011
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	1,024,507	948,899
Inventarë	7	18,040,025	16,730,779
Totali i aktiveve afatshkurtra		31,215,892	27,563,932
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	8	2,432,618	801,346
Kapitali i nënshkruar i papaguar	9	100,000	100,000
Totali i aktiveve afatgjatë		2,532,618	901,346
Totali i aktiveve		33,748,510	28,465,278
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	6,566,544	5,376,725
Llogari të pagueshme tregtare	11	770,633	1,659,124
Detyrime tatimore	12	199,012	337,930
Të tjera detyrime	13	1,994,250	-
Qira financiare	14	671,398	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		10,201,837	7,373,779
Detyrime afatgjatë			
Qira financiare	14	782,533	-
Totali i detyrimeve afatgjatë		782,533	-
Totali i detyrimeve		10,984,370	7,373,779
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Rezerva ligjore		1,092,977	846,668
Fitime të mbartura		19,898,522	15,218,657
Fitimi i ushtrimit		1,672,641	4,926,174
Totali i kapitalit	15	22,764,140	21,091,499
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		33,748,510	28,465,278

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	49,988,745	188,224,994
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	1,243	-
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(43,489,411)	(178,208,082)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	18	(41,243,378)	(174,856,992)
2) Të tjera shpenzime	19	(2,246,033)	(3,351,090)
Shpenzime të personelit	20	(3,446,268)	(3,229,668)
1) Paga dhe shpërblime		(2,953,108)	(2,767,500)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(493,160)	(462,168)
Zhvlerësim i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(563,865)	(207,241)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit		-	-
Shpenzime financiare	21	(272,493)	(418,529)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(552,734)	(418,529)
2) Shpenzime të tjera financiare		280,241	-
Fitimi/humbja para tatimit		2,217,951	6,161,474
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	(545,310)	(1,235,300)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(545,310)	(1,235,300)
Fitimi/humbja e vitit		1,672,641	4,926,174
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		1,672,641	4,926,174

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


AUTO EKSPRES sh.p.k
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2016	100,000	649,205	11,466,852	3,949,268	16,165,325
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:				4,926,174	4,926,174
Transferim ne rezerve ligjore		197,463		(197,463)	-
Transferim ne fitime te mbartura			3,751,805	(3,751,805)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	100,000	846,668	15,218,657	4,926,174	21,091,499
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:				1,672,641	1,672,641
Transferim ne rezerve ligjore		246,309		(246,309)	-
Transferim ne fitime te mbartura			4,679,865	(4,679,865)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	100,000	1,092,977	19,898,522	1,672,641	22,764,140

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 5 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i Auto Ekspres më _____ dhe janë firmosur si më poshtë.


Z. Besnik Bimi
Administrator



Znj. Albana Hoxha
Drejtuuese e Financës



**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	1,672,641	4,926,174
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	552,734	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	563,865	207,241
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:	-	-
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(2,311,031)	(2,116,658)
Rënie/(rritje) në inventarë	(1,309,246)	(3,240,041)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	966,841	(204,491)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	135,804	(427,775)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(2,195,137)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(2,195,137)	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	1,189,819	(807,795)
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare	1,453,931	
Interes i paguar	(552,734)	(418,529)
Dividendë të paguar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	2,091,016	(1,226,324)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	31,683	(1,654,099)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	118,243	1,772,342
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	149,926	118,243
4		

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“Auto Ekspres” sh.p.k është themeluar më 14.07.2011 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe është e regjistruar në Regjistrin tregtar me NIPT L11914003U.

Veprimtaria kryesore e shoqërisë për vitin ushtrimor ka qënë ngritja e një aktiviteti tregtar e shërbimesh si: riparim për të gjitha llojet e markave të automjeteve; importimi i të gjitha llojeve të automjeteve dhe të markave; shitja me shumicë dhe pakicë e pjesevë të këmbimit, gomave, nyjeve servis universal për të gjitha llojet e automjeteve, qiradhënie e automjeteve etj.

Ortaku i vetëm i shoqërisë është Z. Besnik Bimi, i cili zotëron një kapital prej 100,000 lek, i ndarë në 100 kuota (1,000 Lek/secila).

Administrator i shoqërisë është Z. Besnik Bimi.

Shoqëria gjatë vitit 2017 ka pasur 4 punonjës (2016:4 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara (SKKP) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
EUR/Lek	132.95	135.23
USD/ Lek	111.10	128.17

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Instrumenta dhe vegla pune	Vlera e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe lidhjes që ato kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pavarësisht nëse arkëtimi i tyre apo i një pjese prej tyre do të ndodhë në një ushtrim pasardhës.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare), të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësishme ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike gojnë në rritjen e kapitaleve të veta.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.11. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në bankë	142,175	77,191
Mjete monetare në arkë	7,751	41,052
	<u>149,926</u>	<u>118,243</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Kliente për fatura të pranuar	12,001,434	9,766,011
	<u>12,001,434</u>	<u>9,766,011</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Tatimi mbi fitimin	990,415	948,029
Mbipagesa ne Dogane	-	870
Te tjera	34,092	-
	<u>1,024,507</u>	<u>948,899</u>

7. Inventarë

Gjendja e inventarit paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Pjesë këmbimi	18,040,025	16,730,779
	<u>18,040,025</u>	<u>16,730,779</u>

AUTO EKSPRES sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

8. Aktive Afatgjata Materiale

	Mobilje orendi	Pajisje Informatike	Makineri Pajisje	Automjetet	Te tjera	Totali
Gjëndja më 1 Janar 2016	8,000	252,658	490,000	1,260,000	10,500	2,021,158
Shtesa	-	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	8,000	252,658	490,000	1,260,000	10,500	2,021,158
Shtesa	-	19,094	-	2,598,817	-	2,617,911
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(1,260,000)	-	(1,260,000)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	8,000	271,752	490,000	2,598,817	10,500	3,379,069
Amortizimi / Akumuluar						
Gjëndja më 1 Janar 2016	(4,534)	(142,185)	(137,522)	(722,400)	(5,930)	(1,012,571)
Amortizimi i vitit	(693)	(27,618)	(70,496)	(107,520)	(914)	(207,241)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	(5,227)	(169,803)	(208,018)	(829,920)	(6,844)	(1,219,812)
Amortizimi i vitit	(554)	(23,259)	(56,396)	(482,925)	(731)	(563,865)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	837,226	-	837,226
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	(5,781)	(193,062)	(264,414)	(475,619)	(7,575)	(946,451)
Vlera neto kontabël						
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	2,773	82,855	281,982	430,080	3,656	801,346
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	2,219	78,690	225,586	2,123,198	2,925	2,432,618

9. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Kapital i nënshkruar por i papaguar nga Ortaku i Vetëm	100,000	100,000
	<u>100,000</u>	<u>100,000</u>

10. Hua afatshkurtra

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Overdraft Veneto Bank	6,566,544	5,376,725
	<u>6,566,544</u>	<u>5,376,725</u>

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Furnitorë	770,633	1,659,124
	<u>770,633</u>	<u>1,659,124</u>

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
TVSH per t'u paguar	110,798	259,205
Tatim mbi te ardhurat personale	17,397	14,381
Kontribute per Sigurimet Shoqerore dhe Shendetesore	70,817	64,344
	<u>199,012</u>	<u>337,930</u>

13. Te tjera detyrime

Te tjera detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari pronari	1,994,250	-
	<u>1,994,250</u>	<u>-</u>

14. Qira financiare

Qirat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Qira financiare afatshkurtër	671,398	-
Qira financiare afatgjatë	782,533	-
	<u>1,453,931</u>	<u>-</u>

15. Kapitali

	31 dhjetor 2017			31 dhjetor 2016		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Z. Besnik Bimi	100	1,000	100%	100	1,000	100%
	100	1,000	100%	100	1,000	100%

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga pjesët e këmbimit	49,717,342	60,625,467
Të ardhura nga shitja e makinave	-	127,140,677
Të ardhura nga riparimet dhe montimet	271,403	458,850
	49,988,745	188,224,994

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Qarkullim i tatueshëm	50,412,763
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	49,988,745
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	72,649
Shtohet Vlera kontabël neto e AAM-ve të shitura përfshirë në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	351,369
Sipas Kontabilitetit	50,412,763
Diferenca	-

17. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja e AAM-ve	424,018	-
Vlera kontabël neto e AAM-ve të shitura	(422,775)	-
	1,243	-

18. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme dhe shërbime

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për blerjen e makinave	1,332,699	126,509,554
Shpenzime për blerjen e pjesëve të këmbimit	38,622,605	46,818,662
Shpenzime për qiranë e magazinave	1,129,800	1,155,000
Shpenzime për riparimin e makinave	148,414	365,180
Taksa automjesh	9,860	8,596
	<u>41,243,378</u>	<u>174,856,992</u>

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime administrative	(68,587)	138,528
Shpenzime sigurimi	82,769	16,950
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	90,556	102,538
Shpenzime udhëtimi, diëta	66,484	172,733
Shpenzime reklame	41,706	25,150
Shpenzime bankare	328,191	371,863
Shpenzime të tjera	41,360	194,533
Shpenzime fotokopje dhe noterizime	24,650	17,100
Shpenzime për shërbime konsulence	154,452	169,385
Shpenzime të pazbritshme	1,417,452	2,073,861
Humbje nga kembimet valutore	-	1,449
Taksa dhe tarifa vendore	67,000	67,000
	<u>2,246,033</u>	<u>3,351,090</u>

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për paga	2,953,108	2,767,500
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	493,160	462,168
	<u>3,446,268</u>	<u>3,229,668</u>

21. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet dhe të ardhurat nga interesat. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Humbje nga këmbimet valutote	16,726	-
Të ardhura nga këmbimet valutore	(296,967)	-
Shpenzime per interesa	552,734	418,529
	<u>272,493</u>	<u>418,529</u>

22. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Fitimi para tatimit	2,217,951	6,161,474
<i>Shpenzime të panjohura të tjera</i>	<i>1,417,452</i>	<i>2,073,861</i>
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	3,635,403	8,235,335
Tatim fitimi 15%	<u>545,310</u>	<u>1,235,300</u>
Fitimi i vitit	<u>1,672,641</u>	<u>4,926,174</u>

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Me 1 Janar	948,029
Parapagime gjate vitti	587,696
Shpenzime te vitit	(545,310)
Tatim Fitimi	<u>990,415</u>

23. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.